



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.773/13

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit nga [] te cilin e përfaqëson Av. [] kundër të paditurve [] te cilët i përfaqëson [] a dhe Komuna e [], pas mbajtjes së seancës kryesore në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të të paditurit parë dhe dytë: 13.01.2015, me datën 14.05.2015 bie këtë:

AKT GJYKIM

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VËRTETOHET** se paditësi: [] nga [] është pronar i ndërtesës në sipërfaqe prej 62 m², pjesë e ngastrës kadastrale [] në bazë të kontratës së shitblerjes, ndërsa shfrytëzues i sipërfaqes prej 155 m² apo 1/17 pjesë ideale e ngastrës kadastrale nr. [] ZK [] ne baze te drejtës se ndërtimit,
- III. **OBLIGOHEN** të paditurit [] dhe Komuna e [] që të drejtën e specifikuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njehin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojë regjistrimin e kësaj të drejtë në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsvatim

Paditësi me anë të padisë ka pohuar se të paditurat si pasardhëse tani të ndjerit [] i cili ka qenë punëtor i ndërmarrjes së atëhershme DP Kompania " [] nga [] ka fituar para 40 viteve ne shfrytëzim një barakë ne sipërfaqe prej 62 m² e cila gjendet ne []



ngastrën kadastrale nr. me kulturë rruge e pakategorizuar e ne
ipërfaqe prej 0.26,72 ha e evidentuar ne fletën poseduese nr. ZK
te cilën barakë e kanë rinovuar dhe ndërtuar shqepin ne
ipërfaqe te njëjtë nga materiali i fort dhe te cilën patundshmëri e kanë
hifrytëzuar pa kurrfarë pengese deri me 20.06.1999 kur për shkak te
akteve notere e kanë lëshuar .

Ne fjalë përfundimtare i autorizuari i paditësi deklaroi se fillimisht e bej
recizimin e kërkesëpadisë se paditësit duke harmonizuar kërkesën me
kspertizën e ekspertit të gjeodezisë ashtu qe i propozoj gjykatës qe te
provon kërkesëpadinë e paditësit nga duke
ërtetuar se i njëjti është pronar i objektit banesor dhe ka te drejtën e
hifrytëzimit te përhershëm te sipërfaqes prej 155 m2 apo 1/17 pjesë
deale te ngastrës nr. me kulturë rrugë e pakategorizuar e regjistruar
e fletën poseduese ZK e azhurnuar me
ne bazë te shitblerjes se bere ne vitin 2007 te cilën gjë te
paditurit janë te obliguar qe ta pranojnë. Konsideroj se me provat e
administruarë është argumentuar bazushmeria e kërkesëpadisë prandaj
propozoj qe gjykata te njëjtën ta miratoj si te bazuar. Shpenzimet e
procedurës nuk i kërkoi.

ërfaqësuesi i të paditurit të parë, të dytë dhe të tret, nuk prezantoi edhe
se është ftuar në mënyre të rregulte dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

ërfaqësuesi i të paditurës së katërt në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se
shtë relevante qe pas vendshiqimit gjykata te jep vlerësimin për objektin
i ne pronësi pasi që të vërtetohet se e njëjta ekziston dhe qëndron ne
eren si një fakt procedural dhe argumentimi për arsye se asnjëherë nga
rganet kompetente nuk është ndërruar veprim përkatës rreth nderimit
e objektit. Kështu qe gjykata ne bazë te rezultatit të provave mund te
nerr ne konsideratë eventualisht edhe te drejtën e shfrytëzimit të truallit
e kufijte si parashihen sipas standardeve për shfrytëzimin e përdorimit
e rregullt te objektit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Ne seancë kryesore gjykata dëgjoi dëshmitarët: i dhe

Ne qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykata
administroi këto prova: ekspertiza xheodete e dt.11.12.2014 bashkë me
kicën e ternit, certifikatat e pronësisë me nr. të njësisë

e datës së lëshimit 12.11.2014, procesverbali i daljes në vend,
kontrata e dt.25.05.2007 e lidhur ne mes paditësit dhe te paditurve,
vendimi i vërtetuar i komisionit për çështje pronësore banesore, skica e
dt.29.05.1996, Shkresa e KEK-ut e lëshuar ne emër te

vërtetimi lëshuar nga Kompania me numër zyrtar e
dt.25 korrik 2003, parashtrësja e te paditurve të parë, të dytë dhe tret, e
paraqitur ne habitët për ndërprerjen e procedurës se përmbarimit për
argimin e paditësit nga pronatani kontestuese, Urdhri i habitatit
i dt.29 gusht 2003.



provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestuese se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese e ka në posedim, pasi këtë fakt gjykata e vërtetoi në momentin e daljes në teren, po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekspertiza gjeodete.

Nuk është kontestuese se ngastra me nr. _____ të tërësi _____ videntohet në emër të të paditurit të katërt, ky fakt vërtetohet në bazë të certifikatës së pronësisë.

Sa i përket çështjes së shitblerjes dhe periudhës së mbajtjes, e po ashtu edhe mirëbesimit në mbajtje, në mungesë të provave tjera për të lëshuar këtë fakt gjykata u bazua në deklarin e dëshmitarëve, të cilët deklaratat e tyre i dhanë nën betim.

Dëshmitari _____ deklaroi se ne vitin 1959 ka qene i ndërtuar objekti me material te fort te cilin te cilin e ka shfrytëzuar një ndërmarrje ndërtimore nga _____ ndërsa me _____ one ka ardhur një ndërmarrje nga _____ dhe këtë objekt e ka shfrytëzuar për nevoja te veta. Ndërtesa i ka pasur dy dhoma, një banjo dhe një korridor. Në vitin 1970-1980 është vendos _____ me ashkëshorten e tij dhe tri vajzat dhe ka jetuar deri kah qershori i vitit 1999. Objekti i cili është ndërtuar ne atë vend ka qene i ndërtuar ne vitin 1959, ndërsa ne oborr e ka ndërtuar edhe një shup nuk i di dimensionet por objektin e ka ndërtuar menjëherë pas vendosjes për anim _____


Dëshmitari _____ deklaroi se e di se është një shtëpi e vjetër një kateshe ne afërsi te shkollës fillore respektivisht ne oborr te shkollës fillore ne _____, ndërtesa është dy dhomshe një kuzhinë dhe një banjo, themeli i saj është ndërtuar prej betoni ndërsa muri me tullë, ulmin e ka vetëm me një ramje, ne pllacin ku është i ndërtuar objekti anesor nuk ka objekte tjera ndihmese dhe është një shupe mbrapa atëpisë.

Dëshmitar i parë nuk është në lidhje familjare me paditësin ndërsa dëshmitari i dyte është ne afërsi me palën paditëse, mirëpo të njëjtit në deklaratat e tyre ishin të sinqertë.

Deklaratat e këtyre dëshmitarëve rreth blerjes se truallit dhe ndërtimit të shtëpisë po ashtu përputhen edhe me faktin se me rastin e daljes në teren gjykata konstatoi një shtëpi te vjetër je kafshe nj epjes prej llastre.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi marrëdhëniet Themelore Juridike Profesore neni 20, ku paditësi të njëjtën e pronësisë në objekt e ka fituar me veprim juridik, ku në rastin konkret veprim juridik është kontrata mbi shitblerjen.

Ndërsa paditësit i takon e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të tokës _____



en objekt dhe përreth objektit e cilaa shërben për nevojat e shfrytëzimit-
ërdorimit të objektit në fjalë kjo sipas Ligjit mbi Tokën Ndërtimore.


rsyeja e aplikimit të Ligjit të mëhershëm qëndron në faktin se baza
juridike e kërkesëpadisë është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky
gj.

Idërsa sa i përket te paditurit parë dhe të dytë, gjykata u bazua edhe në
deklaratën e te autorizuarit të tyre i cili deklaroi se nuk kundërshtoj
adinë dhe kërkesëpadinë e paditësit pasi paditësi i ka përmbushur
bligimet ndaj te paditurve, këtë fakt gjykata e vërtetoi nëpërmjet
ansferit bankar.

a i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të
PK-së, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kërkuan
shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.773/2013 Datë: 14.05.2015



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat
te 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e
përmjet kësaj gjykate.

Exp: Te paditurve
14.5.2015 (Paton Ademi)

17.07

